

Numri i lëndës: 2024:041064

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05428756

C.nr.795/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA V., gjyqtari Raif Fazliu, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen kontestimore të paditësit H.H. nga fshati S., Komuna V., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson G.R., avokat në V., kundër të paditurës Komuna V.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit dhe shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 1,309.30 €, jashtë seancës, me datë 08.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit H.H. nga fshati S., Komuna V., **detyrohet** e paditura Komuna e V.së-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit për 329 ditë të pranisë në punë, për periudhën nga data 02.02.2021 deri më 22.11.2022, t'ia paguajë shpenzimet e ushqimit në shumën 658 € dhe për shpenzimet e udhëtimit t'ia paguajë shumën 230.30 €, në shumë të përgjithshme **888.30 €**, me kamatë ligjore 8%, e llogaritur nga dita kur është ushtruar padia me datë 05.02.2024 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit ligjor.

II. Refuzohet pjesërisht pjesa tjetër e kërkesëpadisë në emër të shpërblimit jubilar, e kërkuar për 30 vjet të përvojës në punë, në shumën 421 €.

III. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë 125 € në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit nën kërcënim të përbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarës së tij, me datë 05.02.2024, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit dhe shpërblimit jubilar, në vlerë të kontestit 1,309.30 €.

Me padi, paditësi ka theksuar se është i punësuar në Sh.F.M.U. "N.R." në fshatin S.E., në V., me orar të plotë të punës andaj, nga gjykata ka kërkuar që e paditura, për periudhën nga data 02.02.2021 deri më 22.11.2022, përkatësisht për 329 ditë pune t'ia paguajë shumën 658 € në emër të shpenzimeve të ushqimit, shumën 230.30 € në emër të shpenzimeve të udhëtimit dhe për 30 vjet të përvojës së punës, shumën 421 € apo 100 % të pagës bazë, në total shumën 1,309.30 €. Si prova materiale gjykatës i ka propozuar: Vërtetimin e punës numër 84/23, të datës 06.11.2023; Vërtetimin e punës nr. 791, të datës 29.09.2023; Çertifikatën e vendbanimit B 10374694, të datës 29.03.2022; Vërtetimin nga kompanitë e transportit të udhëtarëve që veprojnë në kuadër të Komunës së V.së dhe Listën e pagave EM 00057674. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar edhe atë, shumën 104 € për përpilimin e padisë dhe shumën 21 € për taksën gjyqësore për padi.

E paditura, përmes përgjigjes në padi, e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi që obligimet e parapara në KKAK duhet të paguhen nga niveli qendror, Ministrinë përkatëse dhe anën tjetër, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit e kanë shkëputur këtë kontratë andaj rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën si dhe, sipas Ligjit të Punës, kërkesëpadia është përfshirë në parashkrim prandaj, gjykatës i ka propozuar të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit të pa bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pas pranimit të përgjigjes në padi, gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës gjyqësore, duke u mbështetur në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), me të cilin përcaktohet se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar sepse, gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadia e paditësit si dhe nenin 399.1 që përcakton se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pa themeltë kërkesëpadia”.

Gjykata në këtë çështje juridike civile, ka gjetur se faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese, përkatësisht: ekzistimi i marrëdhënies së punës, lartësia e pagës e poashtu se nga data 02.02.2021 deri më 22.11.2022, paditësi ka qenë i pranishëm në punë 329 ditë dhe se gjatë kësaj periudhe kohore ka udhëtuar në relacionin Sadovinë e Qerkezëve-S.E. dhe anasjelltas, pasi edhe e paditura nuk i ka kontestuar këto fakte. Kontestuese për gjykatën është vetëm fakti nëse paditësit i takon shpërblimi jubilar për 30 vite përvojë pune apo jo.

Gjykata, duke u mbështetur në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje meritore në këtë çështje juridike kontestimore, pasi provat materiale janë lëshuar nga organi shtetëror, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Andaj, duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, lidhur me nenin 35, par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK), të datës 18.04.2017 dhe KKAK-së të datës 22.01.2021, ku është përcaktuar se: “Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim

kompensimin për ushqim”, par. 5 i cili ka përcaktuar se: “Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”, dhe paragrafi 8, pika 8.3 se “Punëtorët (anëtarë të SBASHKUT-ut), në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, ashtu që për 30 vite të përvojës së punës i kompensohet 100% të pagës bazë”, gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata refuzoi pjesërisht kërkesëpadinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimit pasi që kërkesa për kompensimin e shpërblimit jubilar për 30 vjet përvojë pune nuk ka bazë ligjore meqë paditësi, V.n e 30 jubilar e ka mbushur me datë 31.01.2024 ndërkaq, KKAK, në fuqi nga data 22.01.2021, për palët nënshkruese të saj nuk krijon të drejta dhe detyrime pas datës 21.11.2022 sepse po në këtë datë MASHTI ka deklaruar se e shkëputë kontratën.

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara sepse palët kontraktuese të KKAK-së, (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” ndërsa, neni 37 ka përcaktuar se: “Palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe t’i respektojnë dispozitat e kësaj kontrate”.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së

Gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u mbështetur në nenin 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi e paditura e ka humbur kontestin gjyqësor dhe për këtë arsye u detyrua t’ia paguajë paditësit shpenzimet për taksë në shumën 21 € dhe për përpilimin e padisë shumën prej 104 €, në shumë të përgjithshme prej 125 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 dhe 398 e 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË V.

C.nr.795/2024, datë 08.03.2024

G j y q t a r i,

Raif Fazliu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.